

NOTË INFORMUESE

Tiranë, më 08.06.2026

Mbi kërkesën e ILD-së drejtuar KLP-së për rishqyrtimin e kërkesës për procedim disiplinor të magjistrates A.K.

Gjykata Administrative e Apelit ka pranuar më datë 24.03.2026 ankimimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ndaj vendimit të KLP-së të datës 02.10.2025, me të cilin është rrëzuar kërkesa e ILD për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje publike" ndaj magjistrates A.K., prokurore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102 pika 1 shkronjat "j" dhe "g" të ligjit "Për Statusin", Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur:

1. *Pranimin e Padisë.* 2. *Shfuqizimin e vendimit nr. 302, datë 02.10.2025 të KLP.* 3. *Detyrimin e palës së paditur KLP të rimarrë në shqyrtim kërkesën e ILD për procedimin disiplinor nr. 1371/2, datë 31.07.2025 ndaj prokurores A.K.* 4. *Shpenzimet Gjyqësore i ndarkohen palës së paditur.* 5. Kundër këtij vendimi lejohet Rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë brenda 30 ditëve, duke përcaktuar në këtë vendim edhe detyrat përkatëse për KLP-në dhe konkretisht:

- Të zhvillojë një analizë të plotë dhe të drejtëpërdrejtë mbi rrethanat konkrete të konstatuara, duke vlerësuar në mënyrë të qartë raportin e tyre me përgjegjësinë funksionale të magjistratit (pra, të mos devijohet përgjegjësia vetëm tek kryesekretarja e protokollit të Zyrës së Prokurorisë Korçë);
- Të shmangë zhvendosjen e analizës drejt elementëve të tjerë që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e përgjegjësisë disiplinore)
- Të interpretojë dispozitat ligjore të zbatueshme në përputhje me tekstin dhe qëllimin e tyre, pa patur elementë që nuk parashikohen nga ligjvënësi (interpretimi i nenit 103 të K.Pr.Penale),
- Të zhvillojë një arsyetim të plotë, të qartë dhe koherent, i cili të bëjë të mundur verifikimin e mënyrës së ushtrimit të pushtetit diskrecionar dhe të lidhjes së analizës së kryer dhe përfundimit të arritur (të hiqet pjesa e relacionit përfundimtar dhe të arsyetohen gjithë pretendimet e palëve);
- Të vlerësojë në mënyrë të argumentuar raportin ndërmjet rrethanave të konstatuara dhe pasojës disiplinore, në funksion të garantimit të një vendimmarrje të bazuar në ligj dhe të kontrollueshme gjyqësisht (parimi i proporcionalitetit dhe arsyetim i përgjegjësisë disiplinore)

Në vijim të procedurës për rishqyrtimin e kërkesës së ILD-së për procedimin disiplinor të magjistrates znj. Anjeza Kalanxhi, bazuar edhe në vendimin nr. 78, datë 08.05.2026 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ILD kërkon nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë të vendosë: "Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedimin disiplinor ndaj magjistrates A.K., me detyrë prokurore e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1 shkronjat "g" dhe "j" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe caktimin ndaj saj të masës disiplinore "**Vërejtje publike**".